



KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 27, datë 18.07.2019

**Mbi shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Drejtues nr.183, datë 28.09.2007
“Për miratimin e Manualit të Operacioneve Monetare për SAMFSH”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 53, pika 6 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 8, pika 3 të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 9, shkronja “d” të Rregullores nr. 17, datë 28.07.2016 “Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 6, pika 7, shkronja “a” dhe të nenit 15 dhe 22, pika 3 të Rregullores nr.25, datë 31.10.2018 “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e njërive organizative të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të nenit 18 Rregullores nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues

V E N D O S I:

1. Të shfuqizojë Vendimin e Këshillit Drejtues nr.183, datë 28.09.2007 “Për miratimin e Manualit të Operacioneve Monetare për SAMFSH”.
2. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm për miratimin e Manualit të Operacioneve Monetare për administrimin e mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar